



Uni Banka SHA Shkup ka nevojë për kandidatë të motivuar dhe të talentuar, që do të punësohen në pozicionet më poshtë:

## Referent në Shërbimin Qendra e kontaktit

*Bëhu edhe ti pjesë e ekipit tonë...*

### **Kualifikimet:**

- Arsim i lartë profesional
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi
- Aftësi për të punuar në grup
- Pozitivë, të përgjegjshëm dhe të përkushtuar
- Njohje të paketës MS Office
- Njohje të shkëlqyer të gjuhës shqipe
- Fleksibilitet dhe mundësi për të punuar me turne

## Aktivitetet e punës:

- Jep informacione lidhur me produktet dhe shërbimet e Bankës, në një mënyrë të kuptueshme dhe të kapshme për klientët
- Profesionalizëm dhe vetëkontroll gjatë situatave problematike
- Njohje të produkteve të Bankës dhe kontribut për zhvillimin e papenguar të të gjitha aktiviteteve
- Sigurim informacionesh me telefon ose postë elektronike për klientët momental ose të mundshëm, si më poshtë vijon:
  - Informacione për ato që duan të aplikojnë për një produkt/shërbim konkret
  - Informacione për ndryshimin e parametrave të produktit/shërbimit që e përdorin klientët për momentin (ndryshimi i normës së interesit, afatit ose kushteve të tjera)
  - Prezantim të produkteve/shërbimeve të reja me të cilat Banka futet në treg
  - Oferta, promocione dhe shitje e kryqëzuar, me qëllim që të ofrohet një produkt konkret, të cilin klientët nuk e përdorin për momentin
  - Përkujtim – lidhur me detyrimet, në rastet e mospërbushjes së obligimeve, skadimit të afatit të kartave të debitit ose kreditit, etj.

Orari i punës është 8 orë në ditë ose 40 orë në javë, nga e hëna në të premten.

Nëse jeni individë me përgjegjësi, precizë dhe aktivë, të orientuar drejt arritjes së rezultateve të larta, Ju mirëpresim në ekipin e suksesshëm të profesionistëve!

Punonjësve tanë u ofrojmë punë dinamike me mundësi për zhvillim profesional dhe përsosje, si dhe kushte të shkëlqyera pune në një ambient me ekip ambicioz dhe profesional.

## Përfitimet:

- Politikë shpërblimi përmes sistemit të bonuseve
- Trajnime për zhvillim personal dhe profesional
- Sigurim kolektiv nga fatkeqësitë, sigurim shëndetësor plotësues
- Aktivitete sportiv dhe shoqërimi

Kandidatët e interesuar që plotësojnë kushtet më lartë, duhet të dërgojnë një biografi të shkurtër në gjuhën maqedonase në e-mailin [jobs@unibank.com.mk](mailto:jobs@unibank.com.mk) ose në adresën: Maksim Gorki nr. 6, 1000 Shkup, deri më **20.03.2024**.

\*Aplikimi juaj do të jetë me karakter konfidencial. Vetëm kandidatët që do të përmbushin kualifikimet dhe kushtet e nevojshme do të ftohen për intervistë. Procesi i selektimit do të finalizohet brenda afateve ligjore, varësisht numrit të të interesuarve. Me aplikimin për këtë vend pune, Ju jeni dakord që Banka të mbledhë, përpunojë dhe ruajë të dhënat Tuaja personale për nevojat e procesit të rekrutimi, gjatë gjithë kohës së vazhdimit të këtij procesi, ndërsa pas mbylljes së tij të dhënat mund të ruhen në bazën e të dhënave të Bankës, për nevojat e rekrutimit dhe sipas normave ligjore. Pëlqimi i dhënë mund të tërhiqet në çdo kohë dhe duke dorëzuar kërkesë në linkun në vazhdim: [zlp@unibank.com.mk](mailto:zlp@unibank.com.mk)